Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur Mbi Kufirin e Lartë Monetar” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Nr. Ref. Procedures baze: REF-04459-09-02-2021, Nr. Ref. Loti 12 – “Pajisje mjekesore të sherbimeve per spitalin e ri”: REF-04489-09-02-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Furnizim Vendosje te Aparaturave Mjekesore per Spitalin e Ri te Ndertuar ne QSUT me Kredi te CEB (Kontributi i Qeverise Shqiptare)”, per vitin 2021, të ndarë në lote (12 lote gjithsej), konkretisht per lotin:

- Loti 12 – “Pajisje mjekesore të sherbimeve per spitalin e ri”

Fondi limit: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për të gjith lotet-12 lote) është: 158.031.554,5 Lekë (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e tridhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër presje pesë) Lekë pa TVSH dhe 189.637.865,4 Lekë (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjatëqind tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje katër) Lekë me TVSH, / Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë

Marrëveshjes Kuadër (per Loti 12 – “Pajisje mjekesore të sherbimeve per spitalin e ri”): 4,659,155(kater milion e gjashtëqind e pesëdhjete e nente mije e njeqind e pesëdhjete e pese) lek pa TVSH dhe 5,590,986 (pese milion e peseqind e nentedhjete mije e nenteqind e tetëdhjete e gjashte) lek me TVSH, Shumatorja cmimeve për njësi: 650,209(gjashtëqind e pesëdhjete mije e dyqind e nente) lek pa TVSH dhe 780,250.8 (shtateqind e tetëdhjete mije e dyqind e pesëdhjete presje tete) lek me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për një periudhë kohore për 12 mujore nga nënshkrimi i MK;

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike [Nr. 132] [Date 07.09.2021]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot (Loti 12 – “Pajisje mjekesore të sherbimeve per spitalin e ri”), kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- ❖ Operatori Ekonomik BIOMETRIC ALBANIA Sh.p.k me NIPT J61827062E, me ofertë ekonomike: 2,437,500 (dy milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 2,925,000 (dy milion e nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 462,500(katerqind e gjashtedhjetë e dy mije e peseqind) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik FEDOS Sh.p.k me NIPT K01514009I, me ofertë ekonomike: 2,850,000 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe 3,420,000 (tre milion e katërqind e njëzet mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 399,400(treqind e nentedhjete e nente mije e katerqind) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik ISOMETRIC Sh.p.k me NIPT L92207009A, me ofertë ekonomike: 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 430,000(katerqind e tridhjetë mije) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik MONTAL sh.p.k me NIPT: J62009007F, me ofertë ekonomike: 3,320,000 (tre milion e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH dhe 3,984,000 (tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 444,000(katerqind e dyzet e kater mije) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik O.E.S DISTRIMED Sh.p.k me NIPT K31520054N, me ofertë ekonomike: 1,664,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH dhe 1,996,800 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 283,920(dyqind e tetëdhjete e tre mije e nenteqind e njezet) lek pa TVSH.

- ❖ Operatori Ekonomik SAER MEDICAL Sh.p.k me NIPT K31610086D, me ofertë ekonomike: 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 475,920 (katerqind e shtatedhjetë e pese mije e nentëqind e njezet) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik TBS 96 Sh.p.k me NIPT K71407001F, me ofertë ekonomike: 3,857,000 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH dhe 4,628,400 (katër milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e katërqind) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 485,000 (katerqind e tetëdhjetë e pese mije) lek pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

- ❖ Operatori Ekonomik FEDOS Sh.p.k me NIPT K01514009I, me ofertë ekonomike: 2,850,000 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe 3,420,000 (tre milion e katërqind e njëzet mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 399,400 (treqind e nentëdhjetë e nente mije e katerqind) lek pa TVSH.

Per arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, i operatorit ekonomik:

- I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin teknik për kualifikim.
- Nuk i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.

2. Lloji i Pajisjes: Peshore elektrike

Me bateri të rikarikueshme për funksionim deri në 35 orë

*Nuk e plotëson si specifikim pasi në katalog koha maksimale e punës me bateri është 32 orë.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimi teknik si mësipër nuk përmbushet nga OE.

3. Lloji i Pajisjes: Llampë Ekzaminimi portative

Intensiteti i ndriçimit 30 - 100%

*Nuk e përçakton në katalogun e paraqitur.*

Diametri i fushës së rrufesë D10 te pakten 140 mm

*Nuk e përçakton në katalogun e paraqitur.*

Konsumi i energjisë max 16 W

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Ngritja e temperaturës tek pacienti / përdoruesi min 2 ° C Bateri Backup

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimet teknike si mësipër nuk përcaktohet në katalog.

Referuar katalogut të paraqitur nga OE i mësipërm, nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në DST për të cilën operatori ekonomik duhet të plotësoj specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që të merret në konsideratë nga KVO si ofertë e e vlefshme.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzoj ofertën e Operatorit Ekonomik FEDOS Sh.p.k me NIPT K01514009I, për arsye se nuk përmbush specifikimet teknike sipas DST.

- ❖ Operatori Ekonomik ISOMETRIC Sh.p.k me NIPT L92207009A, me ofertë ekonomike: 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njësi: 430,000 (katerqind e tridhjetë mijë) lek pa TVSH.

Per arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, i operatorit ekonomik:

- I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin teknik për kualifikim.
- Nuk i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.

1. Lloji i Pajisjes: Oftalmoskop

Filtra pa të kuqe, blu dhe polarizim

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Ekran që tregon gjendjen e karikimit.

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

10) Dorezë universale e konvertueshme

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Dezinfektimi: Pjesë të Pajisjes që janë krijuar për tu ardhur në kontakt me pacientin ose operatorin duhet të jetë të gjendje për t'u dezinfektuar me lehtësi ose të mbrohen nga një mbulesë sterile e disponueshme.

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

ISO 10942: 2006 Oph ose ekuivalente

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimet teknike si mësipër nuk përcaktohet në katalog.

6) Diapazoni i lenteve jo më i vogël se -30D deri + 20D me hapa jo më të mëdhenj se 1D.

*Nuk e plotëson si specifikim pasi në katalogun e paraqitur diapazoni i lenteve është -20D deri në +20D.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimi teknik si mësipër nuk përmbushet nga OE.

Referuar katalogut të paraqitur nga OE i mësipërm, nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në DST për të cilën operatori ekonomik duhet të plotësoj specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që të merret në konsideratë nga KVO si ofertë e e vlefshme.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzoj ofertën e Operatorit Ekonomik **ISOMETRIC Sh.p.k** me NIPT L92207009A, për arsye se nuk përmbush specifikimet teknike sipas DST.

- ❖ Operatori Ekonomik SAER MEDICAL Sh.p.k me NIPT K31610086D, me ofertë ekonomike: 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH dhe 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njesi: 475,920 (katerqind e shtatedhjetë e pese mije e nentëqind e njezet) lek pa TVSH.

Per arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, i operatorit ekonomik:

- I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin teknik për kualifikim.
- Nuk i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.

1. Lloji i Pajisjes: Oftalmoskop

ISO 10942: 2006 Oph ose ekuivalente

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimi teknik si mësipër nuk përcaktohet në katalog.

Referuar katalogut të paraqitur nga OE i mësipërm, nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në DST për të cilën operatori ekonomik duhet të plotësoj specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që të merret në konsideratë nga KVO si ofertë e e vlefshme.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzoj ofertën e Operatorit Ekonomik SAER MEDICAL Sh.p.k me NIPT K31610086D për arsye se nuk përmbush specifikimet teknike sipas DST.

- ❖ Operatori Ekonomik TBS 96 Sh.p.k me NIPT K71407001F, me ofertë ekonomike: 3,857,000 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH dhe 4,628,400 (katër milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e katërqind) lekë me TVSH.

Per arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të paraqitur dhe vlerësimi/verifikimi i dokumentacionit, i operatorit ekonomik:

- I plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ligjor për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin ekonomik dhe financiar për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta / kapacitetin teknik për kualifikim.
- Nuk i plotëson specifikimet teknike për kualifikim.

1. Lloji i Pajisjes: Oftalmoskop

6) Diapazoni i lenteve jo më i vogël se -30D deri + 20D me hapa jo më të mëdhenj se 1D.  
*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Ekran që tregon gjendjen e karikimit.  
*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.  
9) *Optika e mbyllur pa pluhur dhe sistemi optik asferik.*

10) Dorezë universale e konvertueshme  
*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Lëvizshmëria, transportueshmëria ofrohet në kasë mbrojtëse për ruajtjen e pastër dhe transportin e sigurt.  
*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*



Dezinfektimi: Pjesë të Pajisjes që janë krijuar për tu ardhur në kontakt me pacientin ose operatorin duhet të jetë të gjendje për t'u dezinfektuar me lehtësi ose të mbrohen nga një mbulesë sterile e disponueshme.

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

ISO 10942: 2006 Oph ose ekuivalente

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimet teknike si mësipër nuk përcaktohet në katalog.

### 3. Lloji i Pajisjes: Llampë Ekzaminimi portative

Intensiteti i ndriçimit 30 - 100%

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Diametri i fushës së rrufesë D10 te pakten 140 mm

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Diametri i kokës së dritës 240 mm

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Konsumi i energjisë max 16 W

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Ngritja e temperaturës tek pacienti / përdoruesi min 2 ° C Bateri Backup

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Garancia per paisjet e mesiperme te jete te pakten 1 (nje) vit

*Nuk e përcakton në katalogun e paraqitur.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimet teknike si mësipër nuk përcaktohet në katalog.

Jetegjatesia pa energji elektrike minimalisht 4 ore

*Nuk e përmbush si specifikim pasi jetëgjatësia me një bateri është 2 orë.*

Referuar katalogut të paraqitur nga OE në përmbushje të pikës d) tek 2.3 Kapaciteti Teknik, konstatohet se specifikimi teknik si mësipër nuk përmbushet nga OE.

Referuar katalogut të paraqitur nga OE i mësipërm, nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në DST për të cilën operatori ekonomik duhet të plotësoj specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që të merret në konsideratë nga KVO si ofertë e e vlefshme.

Mbështetur në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*



Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzoj ofertën e Operatorit Ekonomik TBS 96 Sh.p.k me NIPT K71407001F për arsye se nuk përmbush specifikimet teknike sipas DST.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

- ❖ Operatori Ekonomik O.E.S DISTRIMED Sh.p.k me NIPT K31520054N, me ofertë ekonomike: 1,664,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH dhe 1,996,800 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njesi: 283,920(dyqind e tetëdhjete e tre mije e nenteqind e njezet) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik MONTAL sh.p.k me NIPT: J62009007F, me ofertë ekonomike: 3,320,000 (tre milion e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH dhe 3,984,000 (tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njesi: 444,000(katerqind e dyzet e kater mije) lek pa TVSH.
- ❖ Operatori Ekonomik BIOMETRIC ALBANIA Sh.p.k me NIPT J61827062E, me ofertë ekonomike: 2,437,500 (dy milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe 2,925,000 (dy milion e nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë me TVSH.  
Shumatorja cmimeve për njesi: 462,500(katerqind e gjashtëdhjete e dy mije e pesëqind) lek pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**

Drejtuar: “2 N”, me adresë:Paskuqan, Lagja “Paskuqan Fushë”, rruga “Demokracia” Pallati nr. 2 Kati i parë, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit:“Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-10184-11-02-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës/ Marreveshje kuader: “Rikonstruksion i godinës së Repartit të Sigurisë dhe Ceremonialit”, me afat deri më 1 (një) muaj nga lidhja së kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): S’ka  
Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 161 datë 8 Nentor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: “2 N” shpk. NIPTI L31615017L

Vlera: 1,625,900 (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik: “HD-NDERTIM” shpk. Nipti L62011016Q

Vlera: 1,966,349(një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S’ka

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmëshoqërinë“2 N” shpk, me adresë:Paskuqan, Lagja “Paskuqan Fushë”, rruga “Demokracia” Pallati nr. 2 Kati i parë, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,625,900 (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

### **BASHKIA HIMARË**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik " KOLA INVEST " shpk me NIPT: K93103401G dhe “IMPLEX” shpk me NIPT: M17121202C, me përfaqësues të BOE Operatorin ekonomik “KOLA INVEST” shpk.

Adresa: Fier Fier FIER Lagjja "Kryengritja", Rruga "Aulona", Kompleksi "Apollon", Pallati Nr.7, Zone Kadastrale Nr.8531, Numer Pasurie 8/59

Procedura e prokurimit/lotit: “E Hapur e thjeshtuar”.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-06922-09-30-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mbrojtje lumore dhe pyllezim te anes se lumit Borsh”;

Kohëzgjatja e kontratës: 60(gjashtëdhjetë) ditë.

Buletini i njoftimeve publike :Buletini Nr. 146 datë 4 Tetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kan marrë pjesë dy operator ekonomik :

1. BOE " KOLA INVEST " shpk me NIPT: K93103401G dhe "IMPLEX" shpk me NIPT: M17121202C

-Oferta ne vleren prej 9,257,221.4 (nente milione e dyqinde e pesedhjetete e shtate mije e dyqinde e njezete e nje presje kater leke) pa tvsh .

2. BOE "COLOMBO" shpk me NIPT:J82916489E dhe "NDERTIMI" shpk me NIPT:K11325002C

-Oferta ne vleren prej 8,283,427 (tete milione e dyqinde e tetedhjetete e tre mije e katerqinde e njezete e shtate leke) pa tvsh .

Operator ekonomik te skualifikuar:

Është skualifikuar BOE "COLOMBO" shpk me NIPT:J82916489E dhe "NDERTIMI" shpk me NIPT:K11325002C, me oferte ekonomike 8,283,427 (tete miliopne e dyqinde e tetedhjetete e tre mije e katerqinde e njezete e shtate leke) pa tvsh, pasi operatori OE "C O L O M B O" me NIPT J82916489E, eshte perjashtuar nga pjesemarrja ne procedurat e prokurimit publik, duke filluar nga data 05.11.2021-05.11.2022.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE " KOLA INVEST " shpk me NIPT: K93103401G dhe "IMPLEX" shpk me NIPT: M17121202C , me adresë: Fier Fier FIER Lagjia "Kryengritja", Rruga "Aulona", Kompleksi "Apollon", Pallati Nr.7, Zone Kadastrale Nr.8531, Numer Pasurie 8/59 , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,257,221.4 (nente milione e dyqinde e pesedhjetete e shtate mije e dyqinde e njezete e nje presje kater leke) pa tvsh , është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

### **BASHKIA HIMARË**

Drejtuar: Operatorit ekonomik "ASI-2A CO" shpk me NIPT: K53002402C .

Adresa: Fier Fier FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Procedura e prokurimit/lotit: "E Hapur e thjeshtuar".

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-08243-10-14-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Mirëmbajtje rrugë rurale";

Kohëzgjatja e kontratës: 1(një) muaj.

Buletini i njoftimeve publike :Buletini Nr. 151 datë 18 Tetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kan marrë pjesë pese operator ekonomik

1. OE “ASI-2A CO” shpk me NIPT: K53002402C  
-Oferta ne vleren prej 7,398,385 (shtate milione e treqinde e nentedhete e tete mije e treqinde e tetedhete e pese leke) pa tvsh .
2. OE “COLOMBO” shpk me NIPT: J82916489E  
-Oferta ne vleren prej 7,986,632 (shtate milione e nenteqinde e tetedhete e gjashte mije e gjashteqinde e tridhete e dy leke) pa tvsh .
3. BOE “JODY-KOMPANY” shpk me NIPT: J94824803M dhe “Shëndelli” shpk me NIPT:K07924803N  
-Oferta ne vleren prej 7,187,880 (shtate milione e njeqinde e tetedhete e shtate mije e teteqinde e tetedhete leke) pa tvsh .
4. OE “SARK” shpk me NIPT: K52531415H  
-Oferta ne vleren prej 7,980,470 (shtate milione e nenteqinde e tetedhete mije e katerqinde e e shtatedhete leke) pa tvsh .
5. OE “TEA-D” shpk me NIPT: K32522629L  
-Oferta ne vleren prej 7,992,269 (shtate milione e nenteqinde e nentedhete e dy mije e dyqinde e gjashtedhete e nenete leke) pa tvsh .

Operator ekonomik te skualifikuar:

1. Eshte skualifikuar BOE “JODY-KOMPANY” shpk me NIPT: J94824803M dhe “Shëndelli” shpk me NIPT:K07924803N, me oferte ekonomike prej 7,187,880 (shtate milione e njeqinde e tetedhete e shtate mije e teteqinde e tetedhete leke) pa tvsh , per arsye se Operatori ekonomik Jody- Kompany ka paraqitur kerkese per terheqje nga procedura, per arsye se ka hartuar gabim oferten ekonomike, dhe jane shprehur se nuk mund te realizojne punimet. Operatori ekonomik Jody-Kompany nuk ka shlyer dhe detyrimet vendore prane Bashkise Himare.
2. Eshte skualifikuar OE “COLOMBO” shpk me NIPT: J82916489E me ofertë ne vleren prej 7,986,632 (shtate milione e nenteqinde e tetedhete e gjashte mije e gjashteqinde e tridhete e dy leke) pa tvsh , per arsye se Operatori ekonomik “COLOMBO” shpk përjashtohet – 12 (dymbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 05.11.2021-05.11.2022), nga APP.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik, "ASI-2A CO" shpk me NIPT: K53002402C , me adresë: Fier Fier FIER Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6 , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 7,398,385 (shtate milione e treqinde e nentedhete e tete mije e treqinde e tetedhete e pese leke) pa tvsh , është identifikuar si Oferta ekonomike me suksesshme dhe qe ploteson kriteret e kerkuara.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË**

Drejtuar: Operatori Ekonomik "SULLOLLARI-KLIMA" Shpk, me NIPT K01529003M, me adresë: Tirane, Rruga "Muhamet Gjollësia 71/3, Kati 1

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur – Prokurim me mjete Elektronike – Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”.

Numri i references se procedures/lotit: REF-07995-10-13-2021.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: „Riparim-mirëmbajtje e Ashensorëve të QSUNT”, për 24 muaj, fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 12,144,672 (dymbëdhjetë milion e njëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

Shumatorja e Cmimeve për Njësi: 260,240 (dyqind e gjashtedhjetë mijë e dyqind e dyzete) Leke pa TVSH,

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

Riparim-mirëmbajtje e Ashensorëve të QSUNT”, për 24 muaj

1. SULLOLLARI-KLIMA” Shpk,

NIPT K01529003M

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 9,988,760 (nente milion e nenteqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtateqind e gjashtedhjetë) Lekë pa TVSH dhe 11,986,512 (njembëdhjetë milion e nenteqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) Lekë me TVSH

*Shumatorja cmimeve për njësi: 255,970 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nenteqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.*

2. “CLIMACASA” Shpk

NIPT L07805502F

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 11,352,340 (njembëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e dyzet) Lekë pa TVSH.

*Shumatorja cmimeve për njësi: 189,677 (njëqind e tetëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtate) lekë pa TVSH.*

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm: Nuk ka oferta ekonomike të pavlefshme

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1- SULOLLARI-KLIMA” Shpk,  
*Emri i plotë i shoqërisë*

NIPT K01529003M  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:9,988,760 (nente milion e nenteqind e tetedhjetë e tete mije e shtateqind e gjashtedhjetë) Lekë pa TVSH dhe 11,986,512 (njembedhjetë milion e nenteqind e tetedhjetë e gjashtë mije e peseqind e dymbëdhjetë) Lekë me TVSH

2-“CLIMACASA” Shpk  
*Emri i plotë i shoqërisë*

NIPT L07805502F  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 11,352,340 (njembedhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mije e treqind e dyzet) Lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Drejtuar:Operatorit Ekonomik “GAMMA” SHPK.

Adresa: Njësia Administrative nr.8, Rruga Dervish Hekali, Ndertesa nr.8, Tiranë.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur, me mjete elektronike”.

Numri i referencës së procedurës: REF-09098-10-21-2021;

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje reagente për nevoja të Isuv”.

Fondi limit: 14,609,639 (katërmbedhjetë milion e gjashtëqind e nente mije e gjashtëqind e tridhjetë e nente) lekë pa TVSH.

Shumatorja e çmimeve për njësi është 7,993,963 (shtate milion e nenteqind e nentedhjetë e tre mije e nenteqind e gjashtë dhjetë e tre) leke pa TVSH.

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

Kohëzgjatja e marrëveshje kuadër do të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë muaj).

Afati i lëvrimit është 35 ditë nga kërkesa që do të drejtohet O.E.

AK do të kërkojë sasisë sipas nevojave që do të krijohen gjatë 12 muajve të zbatimit të marrëveshjes.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Jo.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. O.E “GAMMA” SHPK, me NUIS K31510153H me çmim total 5,496,182 (pesëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe me shumatore e çmimeve për njësi 1,985,012 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. O.E “KRIJON” SHPK, me NUIS K12023001A me çmim total 12,598,500 (dymbëdhjetëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëqind) lekë pa TVSH dhe me shumatore e çmimeve për njësi 4,709,900 (katër milion e shtatëqind e nëntë mijë e nëntë qind) lekë pa TVSH.
3. O.E “ALMedical” SHPK, me NUIS K21511002I me çmim total 246,000 / 7,813,000 (dyqind e dyzet e gjashtë mijë/shtatëmilion e tetëqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe me shumatore e çmimeve për njësi 3,824,870 lekë.
4. O.E “ISOMETRIC” SHPK, me NUIS L92207009A me çmim total 11,965,135 (njëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH dhe me shumatore e çmimeve për njësi 4,402,675 (katër milion e katërqind e dy mijë e gjashtë qind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “AL MEDICAL” SHPK, për arsye si më poshtë vijon:

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur në përputhje me dokumentat e tenderit formularin e ofertës dhe listën e çmimeve. Ne dokumentat e tenderit pika 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: është përzgjedhur pika b ku përcaktohet: “B) *oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x* *Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi.*”.

Nga verifikimi rezulton se O.E ka paraqitur/ofertuar dy vlera të ndryshme për çmimin total të ofertës, konkretisht në shtojcën 1. formularin e ofertës ka ofertuar pika e) “*çmimi total i ofertës sonë pa TVSH është 246,000 (dyqind e dyzet e gjashtë mijë) lek*” dhe pika f) “*çmimi total i ofertës sonë me TVSH është 295,200 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë*”, ndërsa në shtojcën 2, listën e çmimeve të artikujve ka paraqitur si çmim neto pa TVSH 7,813,000 dhe çmim total me TVSH 9,375,600.

Në shtojcën 1 formularin e ofertës nuk është paraqitur shumatorja e çmimeve për njësi, ndërsa në shtojcën 2, listën e çmimeve të artikujve ka paraqitur si çmim total (mallrat) 3,824,870. Operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur shumatoren e çmimeve për njësi në formularin e ofertës.

Nëse do të llogarisim çmimin total në bazë të çmimeve për njësi rezulton se çmimit total i ofertës i cili duhet paraqitur në formularin e ofertës duhet të jetë 7,813,000 lekë pa TVSH.

Ne zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 3 përcaktohet se nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.



Nga përlllogaritja e korigjimeve rezulton se operatori ekonomik është në kushtet e një gabimi me vlerë absolute prej 97 % të ofertës së paraqitur.

- Në dokumentat e tenderit pika 2.3.3 është përcaktuar “Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sipas përcaktimeve kompani prodhuesi Operatori ekonomik apo bashkimi i operatoreve ekonomik të paraqesi deklaratë mbi autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të garantohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me Prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë produktet e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë artikujt e kërkuar. Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore autorizimi do të dorezohet prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit..

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura rezulton se O.E ka deklaruar si prodhues/distributor “Sigma Aldrich- Gjermani Distributor: Varus- Maqedoni”. Në këtë procedurë “Sigma Aldrich- Gjermani Distributor: Varus- Maqedoni” është deklaruar si prodhues/distributor edhe nga operatori ekonomik “Isometric” shpk. O.E “Isometric” shpk përveç deklaratës në SPE ka ngarkuar edhe letrën e autorizimit datë 27.10.2021 nga Varus për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. REF-09098-10-21-2021, ku ka deklaruar se “Isomeric” shpk është e vetmja kompani e autorizuar në Shqipëri për referenën e mësipërme, nga ku rrjedh se O.E Almedical shpk nuk ka plotësuar pikën 2.3.3 të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92 pika 3 “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e këtij ligji.”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e Operatorit Ekonomik.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

“GAMMA” SHPK me NUIS K31510153H me çmim total 5,496,182 (pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe me shumatore e çmimeve për njësi 1,985,012 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA DIMAL**

Drejtuar: /ARKONSTUDIO SHPK, NIPT: L42019004I, Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33, E-Mail: [info.arkonstudio@gmail.com](mailto:info.arkonstudio@gmail.com), Telefon: 0672020481 Administrator Nasjel Çiço & 4 KPPF shpk NIPT: M01715004E, Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Duri, Pallati Nr 59, Kati Perdhe, Hyrja Nr 4, E-Mail: [fpetku@yahoo.com](mailto:fpetku@yahoo.com) Telefon: 0682655288 me administrator z. Fatri Petku/

Procedura e prokurimit/lotit: PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR SHËRBIME

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: /“Studim Projektim Godina e Bashkisë”, REF-09549-10-26-2021/



Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.\_ ARKONSTUDIO SHPK

NIPT: L42019004I

4 KPPF shpk

NIPT:M01715004E

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera 2 450 000 (dy milionë e katerqind e pesedhjetë mijë ) leke;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: nuk ka

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ARKONSTUDIO SHPK, NIPT:

L42019004I, Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33, E-Mail:

[info.arkonstudio@gmail.com](mailto:info.arkonstudio@gmail.com), Telefon: 0672020481 Administrator Nasjel Çiço& 4 KPPF shpk

NIPT:M01715004E, Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Duri, Pallati Nr 59, Kati Perdhe, Hyrja

Nr 4, E-Mail: fpetku@yahoo.com Telefon: 0682655288 me administrator z. Fatri Petku], se oferta e

paraqitur me vlerë totale prej 2 450 000 (dy milionë e katerqind e pesedhjetë mijë ) leke;/ totali i

pikëve të marra [123,00) është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

### **ALBCONTROL SH.A ( ISH A.N.T.A)**

Për: Operatorin Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k.me NIPT J61820021C me adresë: Rr. Murat Toptani,Gjergji Center, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Armand Shara.

Procedura e prokurimit: REF-11870-11-17-2021, me objekt: “Kontratë për marrje suporti e mbështetje teknike për mirëmbajtjen e rrjetit për shërbimet e sistemit IT”, me fond limit 1 600 000 ( një milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 1Dhjetor 2021, ora 10:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nuk ka.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k.me NIPT J61820021C
  - Çmimi i ofertës: 1 526 040(një milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyzet) lekë pa tvsh

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k.me NIPT J61820021C me adresë: Rr. Murat Toptani,Gjergji Center, Tiranë, me përfaqësues ligjor z. Armand Shara, ka paraqitur ofertën me vlerë 1 526 040(një milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyzet) lekë pa tvsh, e cila është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TE TRANSPORTIT** **RRUGOR TIRANË**

Drejtuar: *Bashkimit të operatorëve ekonomik “NIKA shpk & PEPA GROUP GROUP shpk”*  
Adresa: *Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi “Skenderbeu”, godinë 8-katëshe, kati I-rë, Zona Kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587, Shkodër*  
*Autostrada Tiranë-Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr.pasurie 1168/13, Tiranë*

Procedura e prokurimit/lotit: *Procedurë e hapur*

Numri i procedurës / referenca e Lotit: *REF-06967-10-01-2021*

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Rikonstruksioni i Qendrës së Kontrollit Teknik dhe sheshit funksional në DRSHTRR Korçë”*

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): *Buletini i Njoftimeve Publike: 11 Tetor 2021, nr.148*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “NIKA” shpk

J76705047U

“PEPA GROUP GROUP” shpk

L42215009L

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

*Vlera 18,854,206.16 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) leke pa tvsh.*

2. “EURONDERTIMI 2000” shpk K02003001O  
*Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it*  
Vlera 20,591,510.61 (njëzet milion e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e dhjetë pikë gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

3. “KEVIN KONSTRUKSION” shpk K71401004W  
*Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it*  
Vlera 20,247,714.98 (njëzet milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

4. “AVDULI” shpk J66703306O  
*Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it*  
Vlera 22,839,355 (njëzet e dy milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “EURONDERTIMI 2000” shpk K02003001O  
*Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it*

1-Ne piken 2.1.b te kritereve te vecanta per kualifikim citohet sa me poshte: “Operatori duhet te paraqese; Sigurimin eofertes ,sipas shtojces 3” Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik ‘Eurondertimi 2000’ shpk rezulton qe nuk eshte paraqitur dokumenti. Sa me siper komisioni i vleresimit te ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson kriterin percaktuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.1.b

1. Ne piken 2.3.1 te kritereve te vecanta per kualifikim autoriteti kontraktor ka kerkuar:

a) Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk rezulton qe nuk ka paraqitur pervoje te suksesshme – kontrata te ngjashme. Sa me siper komisioni i vleresimit te ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson kriterin percaktuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.1.

3- Ne piken 2.3.3 te kritereve te vecanta per kualifikim citohet sa me poshte; “Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te kete te punesuar staf inxhinierik per kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt,te perfshire ne licensen e shoqerise:

- 1 (nje) inxhinier ndertimi
- 1 (nje) inxhinier elektrik
- 1 (nje) inxhinier mjedisi
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (nje) inxhinier gjeodet/topograf/markshajder/gjeomatik

Per permbushjen e ketij kriteri,operatoret ekonomike duhet te vetedeklarojne stafin qe disponojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit. Ndersa Operatori ekonomike fitues para lidhjes se kontrates duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:

- kontrate pune e vlefshme,
- diplome perkatese
- si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 3(tre) muajt e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik ‘Eurondertimi 2000’ shpk rezulton qe nuk eshte paraqitur dokumentacion per 1 (nje) inxhinier mekanik. Gjithashtu ne formularin e vetedeklarimit operatori ekonomik nuk ka deklaruar 1 (nje) inxhinier elektrik,1 (nje) inxhinier mjedisi 1 (nje) inxhinier mekanik,1 (nje) inxhinier gjeodet/topograf/markshajder/gjeomatik.

Sa me siper komisioni i vleresimit te ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson kriterin percaktuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.3.

4- Ne piken 2.3.6 te kriterëve te vecanta per kualifikim citohet sa me poshte Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

Operatori Ekonomik të ketë 1 (nje) punonjës– Auditues Energjistik i Certifikuar me titull: Auditues Energjistik ne Ndertesa. Ndersa operatori ekonomik fitues para lidhjes se kontrates duhet te dorezoje dokumentacionet provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, si me poshte:

- Kontrata noteriale e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit),

-Certifikata per audituesin energjistik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

-Audituesi Energjetik duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per muajin e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik ‘Eurondertimi 2000’ shpk rezulton qe nuk eshte paraqitur ne formularin e vetedeklarimit punonjesi Auditues Energjistik i Certifikuar me titull: Auditues Energjistik ne Ndertesa. Si dhe ne SPE nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion vertetues qe OE ploteson kete kriter. Sa me siper komisioni i vleresimit te ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ploteson kriterin percaktuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.6.

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik ‘Eurondertimi 2000’ shpk rezulton qe OE nuk ploteson pikat 2.3.6.b , 2.3.6.c, 2.3.6.d, 2.3.6.e.,2.3.6.f. OE nuk ka paraqitur dokumentacion vertetues ne SPE si dhe nuk i ka cilesuar punonjesit e kerkuar ne pikat 2.3.6.b, 2.3.6.c, 2.3.6.d, 2.3.6.e,2.3.6.f ne formularin e vetedeklarimit.

5- Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës Hidraulik
- 2 (dy) punonjës Elektriçist
- 1 (nje) punonjës Teknik Ndërtimi
- 1 (nje) punonjës Karpentier
- 1 (nje) punonjës Pllakashtrues
- 1 (nje) punonjës Teknik topograf
- 2 (dy) punonjës Saldatore
- 1 (nje) punonjës Murator
- 3 (tre) punonjës Hidroizolues
- 1 (nje) punonjës Mekanik
- 1 (nje) punonjës Suvatimi

•2 (dy) punonjës Bojaxhi

Per sa me siper operatori ekonomik nuk ploteson kriteret per: 1 punonjes Teknik gjeometer, 1 punonjes karpentier, 2 punonjes elektriciste, 1 punonjes bojaxhi.

6- Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik 'Eurondertimi 2000' shpk konstatohet se nuk ploteson piken 2.3.8 ne lidhje me pajisjet e mëposhtme:

- Aparatura për bashkim tubacionesh me metodën "Elektro FUSION JOINT" PE nga DN 25- DN 315 - 1 copë: Pronësi ose me qera
- Nyje inertesh - 1 copë: Pronësi/ me qera/ kontrate furnizimi
- Nyje prodhim betony - 1 copë: Pronësi/me qira/ kontrate furnizimi
- Fabrike asfalti - 1 copë: Pronësi/me qira/kontrate furnizimi

7. Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik 'Eurondertimi 2000' shpk rezulton qe OE nuk ploteson piken 2.3.9 pasi nuk ka dorezuar ne SPE Grafik Punimesh.

8. Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik 'Eurondertimi 2000' shpk rezulton qe OE nuk ploteson piken 2.3.10 pasi nuk ka dorezuar ne SPE analize teknike.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Bashkimit të operatorëve ekonomik "NIKA shpk & PEPA GROUP GROUP shpk" me Adresa:Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi "Skenderbeu", godinë 8-katëshe, kati I-rë, Zona Kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587, Shkodër; Autostrada Tiranë-Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr.pasurie 1168/13, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,854,206.16 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) leke pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

## **UNIVERSITETI I TIRANËS**

Për: "KRIJON" shpk, me adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë, me NIPT K12023001A.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, e thjeshtuar

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-11769-11-16-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Ngritja e Laboratorit të Analizave të Materialeve dhe Teknologjive në Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturor"

Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë.

Publikime të mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: datë 22.11.2021 / Nr.167

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. *“ISOMETRIC” shpk* *Nipt L92207009A*  
Vlera 0 (zero) lekë pa TVSh.
2. *“KRIJON”shpk* *Nipt K12023001A*  
Vlera 9,119,000 (nëntëmilion njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1. *“ISOMETRIC” shpk* *Nipt L92207009A*

Përkatësisht për arsyen e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar nga AK

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik *“KRIJON” shpk*, me adresë: *Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë, me NIPT K12023001A*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,119,000 (nëntëmilion njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.62/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA ELBASAN**

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: “Zeqiri” sh.p.k. me adresë: FIER Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private, Pasuria nr. 1/1088, Kati Ire.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kazane mbetje urbane”, me fond limit 9.402.022 (nëntëmilion e katërqind e dymijë e njëzet e dy) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2021.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-12083-11-18-2021

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto   
 oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

**1. “Zeqiri” sh.p.k. me Nipt: J67902827A**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 7.899.600 (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë (pa tvsh).

**2. “N.N.Z.K. Shkodra” sh.p.k me Nipt: J66915047G**

Vlra e paraqitur në procedurën e prokurimit është 8.060.000 (tetë milion e gjashtëdhjetë mijë) lekë (pa tvsh).

**3. “ENDI 94” sh.p.k me Nipt: K01423004K**

